



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 140, datë 31.07.2024

MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË
“POSTA SHQIPTARE” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregullores nr.195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOJ SE:

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën janë licencuar, të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Aktualisht shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a., mban licencën nr. 10, datë 25.06.2009, si “Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. (bono thesari) në tregun me pakicë”. Licenca që mban shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a., si shoqëri brokerimi nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara është e njëjtë me shërbimet e investimit si: marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, të përcaktuara në ligjin nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a., ka depozituar në Autoritet raportin e përputhshmërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregullores nr.195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat ligjore.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë komisionere “Posta Shqiptare” sh.a., me kërkesat e ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij, për ofrimin e shërbimit të investimit të marrjes dhe transmetimit të urdhërave të klientit në “Bono Thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI